



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 230 478; Fax: 00 355 4 232 002

Nr. 1048 Prot.

Tiranë, 25.02 2013

UDHËZIM

Nr. 5, datë 25.02.2013

PËR

STANDARDET E PËRGJITHSHME TË MËSUESIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim pikës 11 të nenit 6 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

1. T'u dërgohen "Standardet e përgjithshme të mësuesit"
 - a) DAR-eve dhe ZA-ve,
 - b) IZHA-s,
 - c) Inspektoratit Shtetëror Arsimit.
2. DAR/ZA-të t'u dërgojnë këto standarde institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre.
3. Drejtoret e institucioneve arsimore t'jua vënë mësuesve në dispozicion këto standarde.
4. MASH dhe IZHA t'i publikojnë këto standarde në faqet e tyre përkatëse të internetit.
5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Edukimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MYQEREM TAJAJ



STANDARDET E PËRGJITHSHME TË MËSUESIT

HYRJA

Standardet e përgjithshme të mësuesit, të miratuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përshkruajnë se çfarë duhet të dijë çdo mësues, çfarë duhet të jetë në gjendje të bëjë dhe nga ç'vlera etike dhe të sjelljes duhet të karakterizohet.

Veç këtyre standardeve të përgjithshme, çdo mësues duhet të përmbushë edhe standardet e lëndës ose të lëndëve për të cilat është diplomuar. Kështu, p.sh. mësuesi i matematikës duhet të përmbushë si standardet e përgjithshme, po ashtu edhe standardet e mësuesit të matematikës.

Standardet e përgjithshme të mësuesit karakterizojnë mësuesin bashkëkohor i cili synon dhe arrin të formojë nxënës që janë aktivë në shoqërinë demokratike, në një ekonomi të zhvilluar të tregut dhe janë të përgatitur për bashkëjetesën europiane dhe më gjerë. Shkurt, këto standarde sintetizojnë kërkesat kryesore të sotme të shoqërisë ndaj mësuesve.

Duke unifikuar pretendimet profesionale dhe etike, standardet nuk e kufizojnë origjinalitetin dhe krijimtarinë e mësuesit, madje e nxisin atë.

Dora-dorës që sistemi arsimor zhvillohet, këto standarde rishikohen duke u bërë më pretenduese.

Standardet e përgjithshme të mësuesit janë hartuar pas shqyrtimit të përvojave të mësuesve tanë të suksesshëm dhe qëmtimit në dokumente të ngjashme të vendeve të tjera.

PËRSE VLEJNË KETO STANDARDE?

Këto standarde i vlejnë së pari, vetë mësuesit. Mësuesi mbështetet në to për të dalluar anët e veta të forta e ato të dobëta, si dhe për të kuptuar më mirë përparimin e tij profesional, pra, i duhen për t'u vetëvlerësuar.

Mësuesi, gjithashtu, mbështetet te të dyja llojet e standardeve, të përgjithshmet dhe ato lëndore, për të përcaktuar më qartë drejtimit e zhvillimit të tij të mëtejshëm profesional, pra, i duhen për t'u vetëpërmirësuar.

Nga ana tjetër, ata mësues që janë mentorë e kanë mjaft më të lehtë të planifikojnë ndihmën e duhur ndaj praktikantëve, falë këtyre standardeve.

Standardet e mësuesit ia lehtësojnë mjaft punën drejtorit të institucionit arsimor, kur i duhet të përmbledhë nevojat profesionale të mësuesve e të menaxhojë pastaj, bashkë me ta, hartimin e zbatimin e planit afatmesëm dhe planit vjetor të zhvillimit profesional të institucionit. Gjithashtu, drejtorit i duhen të dyja llojet e standardeve për të vlerësuar periodikisht mësuesit, për të kuptuar ngritjen e tyre profesionale dhe për të gjetur ose porositur, bashkë me ta, literaturën më të nevojshme profesionale.

Vendimi për përzgjedhjen e një mësuesi në një institucion arsimor do të duhet të merret pas përgjigjes së pyetjes "Sa kandidati përmbush të dyja llojet e standardeve të mësuesit?".

Këshilli i mësuesve dhe ekipet lëndore, si dy organizmat e përhershme të zhvillimit të brendshëm profesional të institucionit, mundën tanimë të përcaktojnë më mirë temat e diskutimeve e debateve profesionale dhe të analizojnë më thellë arritjet e nxënësve në sajë të filozofisë që përshkojnë këto standarde.

Përfaqësuesve të komunitetit të institucionit, d.m.th. bordit dhe këshillit të prindërve u shërben shqyrtimi i standardeve për të kuptuar cilësinë e shërbimit arsimor që ofron institucioni.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës pikëniset nga këto standarde për të formuluar politikat kombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe për të hartuar udhëzime, urdhra e rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit. Mbi këto standarde bazohet kualifikimi i mësuesve.

Instituti i Zhvillimeve të Arsimit identifikon nevojat e mësuesve për zhvillim profesional dhe harton programet e trajnimit të tyre, bazuar në këto standarde.

Komisioni i Akreditimit të Trajnimeve i shqyrton aplikimet e agjencive trajnuese nga pikëpamja e dobisë që ato do të sjellin në përmbushjen sa më të mirë të këtyre standardeve të përgjithshme dhe atyre lëndore.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit vlerëson cilësinë e mësuesit duke u mbështetur, në radhë të parë, te këto standarde dhe te standardet lëndore.

Njësitë arsimore vendore (DAR dhe ZA) kanë parasysh të dy llojet e standardeve për të veçuar ato nevoja profesionale, të cilat janë më të domosdoshme për t'u plotësuar në nivel vendor, si dhe për të planifikuar veprimtarinë e rrjeteve profesionale të mësuesve dhe këshillimin profesional të tyre.

Po kështu, njësitë bazë të qeverisjes vendore (bashkitë e komunat) kanë nevojë për këto standarde në mënyrë që të përzgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

Shoqatat e mësuesve, fondacione dhe OJF-të, që japin ndihmesën në arsimin parauniversitar, janë gjithashtu të interesuar për një dokument të plotë të standardeve të mësuesit në mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore.

PËRSHKRIMI PËRMBLEDHËS I SECILIT STANDARD

Standardet janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësuesin dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përmbushur dhe në ç'skallë është përmbushur një standard i caktuar.

Këto standarde nuk mund të jenë të ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi, janë të ndërlidhura dhe duhen menduar si një e tërë, ku secili standard, bashkë me treguesit e tij, vështron një aspekt të rëndësishëm të mësuesit cilësor.

Standardi "Përgatitja shkencore" i kushtohet zotërimit nga mësuesi i anës shkencore të lëndës, parakusht pa të cilin nuk mund të pretendohet më tej.

Standardi "Kompetencat themelore" bazohet në përshkrimin e tyre të neni 13 i Ligjit për Sistemin Arsimor Parauniversitar.

Kompetencat themelore janë pikënisja dhe pikëmbërritja e kurrikulës. Mbi bazën e tyre hartohet dokumentacioni qendror kurrikular dhe zbatohet e krijohet kurrikula e institucionit arsimor, gjithashtu vlerësohet formimi i nxënësve. Mësuesi duhet të kuptojë thellë dobinë e tyre. Aspekte të kompetencave themelore gjenden edhe te standardet e tjera, por te ky standard janë të përqendruara posaçërisht. Aspekte të veçanta të këtyre kompetencave theksohen në disa lëndë më shumë se në të tjerat, por të gjitha lëndët përshkohen prej tyre. Pjesë e tyre janë, gjithashtu, aftësi të tilla ndërkurrikulare si aftësia e të menduarit kritik, e të menduarit krijues, aftësia e menaxhimit të informacionit, aftësia e të punuarit individual në mënyrë të pavarur dhe e punës në grupe të vogla, aftësia e qëndrimit etik ndaj ngjarjeve e dukurive. Mësuesi mundet t'ua kultivojë nxënësve të tij të gjitha këto aftësitë ndërkurrikulare vetëm pasi ai vetë t'i ketë zotëruar mirë ato.

Standardi "Zhvillimi profesional" e vështron mësuesin si nxënës gjatë të gjithë jetës. Një mësues cilësor është në përmirësim të parreshtur, në sajë të reflektimit ndaj përvojës së tij të përditshme, përvojave të kolegëve të tij dhe qëmtimit në literaturën profesionale.

Pikënisja e reflektimeve të tij janë arritjet e nxënësve të tij dhe qëllimi i vetëm është përmirësimi i këtyre arritjeve.

Standardi “Njohja dhe zbatimimi i dokumentacionit arsimor” merret me njohjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo mësues.

Mësuesi e planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore të cilat ndahen në dy grupime. Nga njëra anë, ai duhet të njohë mirë disa dokumente që, ndonëse nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mësimdhënien, përbëjnë themelet e tij si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Karta Europiane e Të Drejtave të Njeriut, Konventa e Të drejtave të Fëmijëve, Ligji mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës etj. Nga ana tjetër, mësuesit i duhet të njohë thellë disa dokumente themelore arsimore, pa të cilat nuk do të mund të zhvillonte proces mësimor sipas këtyre standardeve si Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Korniza Kurrikulare, standardet sipas fushave të të nxënësve dhe programet lëndore.

Një standard tjetër përqendrohet posaçërisht te mësimdhënien e nxënësve. Mësuesi bashkëkohor nuk është vetëm transmetues i të vërtetave të pranuar dhe as thjesht vlerësues i zotërimit të tyre nga nxënësit. Ai ka tanimë role të shumëfishta, çka e bën këtë profesion një sfidë përherë e më interesante. Mësuesi i sotëm është edhe person burimor, lehtësues i procesit të të nxënësve dhe konsulent i nxënësve. Nuk ekziston një metodë universale e mësimdhënies, që mund të përdoret kudo dhe përherë. Merita e mësuesit është të njohë e përdorë larmi metodash dhe të përzgjedhë një të njëjtën ose një kombinim të tyre, sipas natyrës së njohurive, që nxënësit do të përvetësojnë, aftësive e qëndrimeve që duhet të formojë tek ata, sipas veçorive të nxënësve të tij dhe interesave e dëshirave të tyre.

Si një plotësim, madje më shumë si një theksim i standardit për mësimdhënien dhe nxënien është standardi “Përkujdesja për nxënësit me vështirësi në të nxënë”. Ky standard trajton në mënyrë të posaçme përkujdesjen që mësuesi do të duhet të ketë për suksesin e çdo nxënësi e veçanërisht për nxënësit me vështirësi në të nxënë.

Vlerësimi i të nxënësve, si një përmasë e veçantë e procesit të mësimdhënies e nxënies, zë një standard më vete. Mësuesi duhet të përqendrohet më shumë te vlerësimi i procesit të të nxënësve se sa te rezultatet e të nxënësve dhe duke përdorur larmi strategjish e praktikash. Qëllimi i vlerësimit të nxënësve nuk është thjesht nota dhe nuk përfundon shpesh me notë, por synon përmirësimin e të nxënësve të nxënësve.

Standardi “Mësuesi si anëtar aktiv i organizmave në institucion” parashtrohet ato kërkesa ndaj mësuesit që e bëjnë atë një anëtar produktiv në bashkëpunimin me kolegët e tij.

Te formimi i një nxënësi ndikojnë të gjithë mësuesit e tij brenda një institucioni arsimor dhe, nëse përveç dallimeve të natyrshme midis tyre, këta mësues do të kenë diferenca të mëdha për sa i përket filozofisë së kurrikulës së zbatuar, atëherë ndikimet tek ai nxënës nuk do të jenë konvergjente dhe nxënësit do të përfitonin shumë më pak nga sa do të mundnin. Kjo do të ndodhte nëse këshilli i mësuesve nuk do të shndërrohej në një organizatë profesionale, d.m.th. në një tërësi profesionistësh që ka bindje e parime të njëjta profesionale dhe një kuptim të njëjtë për arritjet e nxënësve dhe për strategjitë kryesore të përmirësimit të tyre. Po kështu, nëse mësuesit nuk do të merrnin pjesë aktive në hartimin dhe zbatimin e planeve vjetore dhe afatmesme të institucionit, përkundrazi do t'ia linin drejtorit këtë barrë, ky institucion do të vuante nga një mospajtim kronik. Mësuesi nuk është vetëm dhe thjesht mësues lëndor, por edhe pjesëtar i një komuniteti profesionistësh që interesohet dhe punon për institucionin në të gjitha aspektet e saj.

Standardi “Bashkëpunimi me komunitetin” parashtron, nëpërmjet treguesve të tij, pretendimet ndaj mësuesit për krijimin e një marrëdhënieje të frytshme e të vazhdueshme, kryesisht, me prindërit e nxënësve.

Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës së tyre, që e kuptojnë më mirë atë dhe që kanë aspiratat më këmbëngulëse për të. Për këtë arsye, prindërit janë bashkëpunëtorët e natyrshëm dhe më aktivë të mësuesit. Komunikimi prindër-mësues është thelbësor për të shtuar mundësitë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

Së fundi, standardi “Sjellja dhe etika” merret me etikën dhe sjelljen e mësuesit, si themeli mbi të cilin ndërtohen të gjitha meritat e tjera profesionale.

STANDARDI: PËRGATITJA SHKENCORE

Mësuesi zotëron anën shkencore të lëndës.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. zotëron strukturën shkencore të lëndës dhe konceptet themelore bashkëkohore të saj, si dhe lidhjet në mes tyre;
2. zotëron metodat e kërkimit shkencor të lëndës;
3. njeh lidhjet shkencore të lëndës me lëndë të tjera;

4. njeh historinë e zhvillimit shkencor të lëndës;
5. zotëron njohuri të lëndëve të tjera, të cilat janë të domosdoshme për lëndën e tij;
6. është në dijeni të risive kryesore shkencore që i përkasin lëndës.

STANDARDI: KOMPETENCAT THEMELORE

Mësuesi u kultivon nxënësve kompetencat themelore.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. ka një kuptim të qartë për kompetencat themelore dhe mënyrat e mishërimit të tyre në procesin e mësimdhënies e nxënies dhe të vlerësimit të nxënësve;
2. aftëson nxënësit të komunikojnë me argumente, qartë, rrjedhshëm, me fjalor të pasur, me fjali të strukturuar mirë, duke respektuar drejtshkrimin ose drejtshqiptimin dhe përdorur larmi mënyrash sipas qëllimit të komunikimit;
3. aftëson nxënësit të jenë dëgjues të vëmendshëm, të nxjerrin në pah idetë themelore dhe të veçojnë paqartësitë kryesore;
4. aftëson nxënësit të nxënë lloje të ndryshme tekstesh letrare dhe joletrare, t'i analizojnë duke zbuluar idetë e konceptet themelore, lidhjet mes tyre dhe duke veçuar paqartësitë;
5. zotëron teknikat e hartimit të eseve dhe i aftëson nxënësit të hartojnë ese;
6. zotëron njohuritë e domosdoshme matematike dhe të shkencave natyrore për përmbushjen nga nxënësit të objektivave të programit lëndor;
7. kultivon te nxënësit aftësinë e përdorimit të TIK-ut për realizimin e objektivave të programit lëndor;
8. kultivon te nxënësit aftësinë e përdorimit të burimeve plotësuese në gjuhë të huaj për të thelluar konceptet dhe për të plotësuar informacionin lëndor;
9. kultivon te nxënësit aftësinë e të menduarit kritik;
10. kultivon te nxënësit aftësinë e të menduarit krijues;

11. krijon rregullisht mundësinë që nxënësit të përballen me sfida dhe të papritura për të cilat zbatohen skemat e zgjidhjes së situatave problemore;
12. përdor strategjitë dhe metodat e aftësimit të nxënësve për punë të pavarur individuale brenda dhe jashtë klase;
13. kultivon te nxënësit aftësinë për të punuar në grup brenda në klasë dhe jashtë saj;
14. përzgjedh, sipas dobisë për nxënësit, midis punës individuale të nxënësve, punës së tyre me grupe të vogla dhe punës me të gjithë klasën;
15. ushtron nxënësit të mbajnë qëndrim etik aktiv ndaj ngjarjeve, dukurive, pikëpamjeve e sjelljeve nga këndvështrimi i vlerave demokratike;
16. kultivon te nxënësit kompetencën e marrjes së nismave dhe të sipërmarrjes.

STANDARDI: ZHVILLIMI PROFESIONAL

Mësuesi reflekton vazhdimisht ndaj përvojës së tij, përfiton rregullisht nga përvoja e kolegëve dhe nga literatura profesionale.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. reflekton vazhdimisht ndaj praktikave të tij mësimitdhënëse;
2. bashkëpunon rregullisht me kolegët, brenda ose jashtë institucionit arsimor, me specialistët, prindërit e nxënësit, për të përmirësuar praktikën e veta mësimitdhënëse;
3. krahason arritjet e nxënësve të tij me të kolegëve, gjithashtu me arritjet e nxënësve në nivel vendor dhe ato kombëtar, për të pikasur burimet e tij të suksesit dhe shkaqet e mangësive të tij;
4. harton dhe zbaton planin e tij të zhvillimit të tij profesional për të përmirësuar arritjet e nxënësve;
5. merr pjesë rregullisht në takimet profesionale si ato të këshillit të mësuesve, të ekipit lëndor, të rrjetit profesional etj., përgatitet seriozisht për to, është aktiv në to, ndan përvojat e shqetësimit dhe parashtron ide të reja;

6. studion rregullisht literaturë profesionale nga burime të ndryshme, përfshirë dhe ato elektronike, në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaj.

***STANDARDI: NJOHJA DHE ZBATIMI I DOKUMENTACIONIT
ARSIMOR***

Mësuesi njih mjaftueshëm dokumentet kryesore kurrikulare si dhe dokumente të tjera mbi të cilat mbështetet zhvillimi i kurrikulës.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. ka njohuri¹ për:
 - a) legjislacionin shqiptar që ka të bëjë drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprimtarinë e tij;
 - b) dokumente të politikës sonë arsimore;
 - c) akte nënligjore, urdhra e udhëzime të Ministrit të Arsimit e Shkencës, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij;
2. njih standardet e përgjithshme të mësuesit dhe të mësuesit lëndor;
3. zotëron Kornizën Kurrikulare, standardet e fushës përkatëse të të nxënit, programin/ programet lëndore dhe materialet e tjera zyrtare që kanë të bëjnë me zbatimin e kurrikulës;
4. njih procedurat e organizimit të kurrikulës në institucionin arsimor.

¹ “Ka njohuri mbi një dokument” do të thotë që mësuesi të jetë në gjendje t’u përgjigjet pyetjeve mbi ato pjesë të dokumentit, që lidhen me detyrat e tij, duke sjellë shembuj konkret të zbatimit.

STANDARDI: MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA

Mësuesi përdor larmi strategjish dhe praktikash të mësimdhënies e nxënies sipas veçorive të nxënësve të tij.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. ka njohuri të përditësuara mbi veçoritë e zhvillimit të fëmijëve të grup-moshës përkatëse;
2. përdor praktika të larmishme të procesit të mësimdhënies e nxënies, në mënyrë krijuese, në përputhje me veçoritë e nxënësve;
3. motivon nxënësit me larmi mënyrash duke krijuar një atmosferë të nxëni intensiv dhe me emocione të këndshme;
4. ka parësor përvetësimin e thellë nga nxënësit të koncepteve kryesore të lëndës dhe zbulimin e lidhjeve në mes tyre;
5. vendos vazhdimisht nxënësit përballë sfidave të të nxënit, por duke mos i mbingarkuar në vëllim njohurish dhe me shkallë vështirësie;
6. shmang shtjellimin vetëm teorik të lëndës duke e konkretizuar rregullisht dhe u kërkuar nxënësve ta konkretizojnë me situata të jetës së tyre të përditshme dhe me dukuri të botës reale;
7. aftëson nxënësit të thellojnë konceptet dhe pasurojnë informacionet e tekstit shkollor me anën e burimeve të larmishme plotësuese, përfshirë vëzhgimet e dukurive dhe bisedat me persona burimorë;
8. kultivon te nxënësit integrimin e lëndëve dhe të fushave të të nxënit;
9. organizon mësimdhënien e nxënien sipas objektivave të arritjeve të nxënësve;
10. harton dhe zbaton projekte kurrikulare në bashkëpunim me nxënësit dhe prindërit e tyre dhe nxitur nismat e tyre;
11. merr pjesë aktive në hartimin e kurrikulës me zgjedhje të lirë duke bashkëpunuar me nxënësit dhe prindërit e tyre;

12. zotëron një kuptim të qartë mbi temat ndërkurrikulare dhe i trajton ato nëpërmjet lëndës/lëndëve.

STANDARDI: PËRKUJDESJA PËR NXËNËSIT ME VËSHTIRËSI NË TË NXËNË

Mësuesi ka bindjen se të gjithë nxënësit janë të zotë të nxënë dhe i krijon çdo nxënësi kushtet që të përmirësojë vazhdimisht arritjet e tij.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. zbaton teorinë e inteligjencave të shumëfishta në veprimtarinë e tij me nxënësit;
2. këshillohet me mësuesit e tjerë dhe me psikologun për të identifikuar barrierat e të nxënësve të veçantë;
3. përdor strategji të diferencuara mësimdhënieje e nxënieje që i shkojnë më përshtat nxënësve:
 - a) duke hartuar programe mësimore të individualizuara;
 - b) duke u kushtuar më shumë kohë jashtë klase, nxënësve me vështirësi në të nxënë;
4. krijon në klasë një kulturë mikpritjeje dhe bashkëpunimi nga nxënësit e tjerë për nxënësit me aftësi të kufizuara;
5. bashkëpunon posaçërisht, me prindërit e nxënësve me vështirësi në të nxënë.

STANDARDI: VLERËSIMI I TË NXËNIT

Mësuesi vlerëson rregullisht procesin e të nxënimit dhe arrijtjet e të nxënimit me qëllim që të kuptojë se si nxënësit nxënë, çfarë ata dinë dhe janë në gjendje të bëjnë.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. ka për bazë në vlerësimin e procesit dhe të rezultateve të të nxënimit, kompetencat themelore, standardet e të nxënimit dhe objektivat e programeve lëndore;
2. vlerëson jo thjesht faktet, por kryesisht formimin e koncepteve bazë dhe lidhjet në mes tyre;
3. zbaton rregullisht strategjitë dhe praktikatat e vlerësimit të procesit dhe të rezultateve të të nxënimit;
4. zbaton teorinë dhe praktikatat e hartimit të testeve e të përpunimit statistikor të tyre;
5. zotëron praktikatat e vlerësimit të nxënësve në projekte kurrikulare;
6. sqaron paraprakisht nxënësit për kriteret dhe mënyrën se si do të vlerësohen;
7. nxit dhe ushtron nxënësit të reflektojnë mbi të nxënimit e tyre, të vetëvlerësohen dhe të vlerësojnë njëri-tjetrin;
8. ushtron nxënësit të vetëanalizojnë anët e forta dhe ato të dobëta në përvetësimin e lëndës.

STANDARDI: MËSUESI SI ANËTAR AKTIV I ORGANIZMAVE NË INSTITUCION

Mësuesi është anëtar aktiv i organizmave në institucion si këshilli i mësuesve, ekipi lëndor e grupe pune.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. bashkëpunon me kolegët për hartimin dhe realizimin e përmirësimeve në institucion;

2. mirëpret dhe inkurajon risitë e kolegëve, propozimet e nismat e tyre për përmirësimin e kushteve të të nxënit;
3. propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të të nxënit dhe të arritjeve të nxënësve në institucion;
4. punon aktivisht në grupe pune që krijohen në institucion;
5. ndihmon mësuesit e rinj.

STANDARDI: BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN

Mësuesi bashkëpunon me prindërit dhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit për përmirësimin e arritjeve të fëmijëve të tyre dhe të nxënësve në përgjithësi.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. beson se bashkëpunimi i vazhdueshëm me prindërit është i domosdoshëm për përmirësimin e arritjeve të fëmijëve të tyre dhe të nxënësve në përgjithësi;
2. përdor mënyra të larmishme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin;
3. u siguron prindërve, informacionet e nevojshme dhe në kohën e duhur për arritjet e fëmijës së tyre (nëpërmjet mësuesit kujdestar ose drejtpërdrejt);
4. ndihmon prindërit të kuptojnë kërkesat e kurrikulës ndaj fëmijës së tyre;
5. nxit prindërit të japin ndihmesën e tyre vullnetare, sipas njohurive dhe profesioneve të tyre:
 - a) si persona burimorë për nxënësit e mësuesit;
 - b) për të hartuar ose venë në jetë module me zgjedhje;
 - c) për të bashkëpunuar në projekte kurrikulare;
 - d) për të punuar me nxënës me vështirësi në të nxënë.

STANDARDI: ETIKA DHE SJELLJA

Mësuesi demonstroi norma të larta të etikës dhe të sjelljes ndaj nxënësve dhe kolegëve.

TREGUESIT

Mësuesi:

1. respekton të drejtat e liritë e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe është i aftë të krijojë në mjediset e të nxënësve atmosferën ku respektohen këto të drejta;
2. krijon një mjedis miqësor për nxënësit;
3. nuk ushtron diskriminim, dhunë, keqtrajtim e dëm moral të nxënësit dhe të personeli;
4. kultivon te nxënësit respektin ndaj dallimeve individuale, kulturave të etnive dhe popujve të tjerë:
 - a) duke përdorur stile dhe praktika të ndryshme të komunikimit me nxënësit, kolegët, prindërit etj.;
 - b) duke komunikuar hapur, në mënyrë korrekte, bindëse dhe frymëzuese me nxënësit;
 - c) duke krijuar në mjediset e të nxënësve frymën e komunikimit të hapur e të lirshëm të nxënësve me të dhe të nxënësve në mes tyre;
5. krijon një atmosferë, ku nxënësit ndjehen të lirshëm të pyesin atë dhe shokët dhe të mos kenë frikë se gabojnë, si dhe kultivon kurajën e tyre për të shprehur mendimin vetjak;
6. është i përkushtuar, entuziast dhe i aftë të krijojë te nxënësit një kulturë përkushtimi e entuziazmi;
7. është transparent në veprimtarinë e tij dhe krijon në mjediset e të nxënësve kulturën e transparencës;
8. është i hapur ndaj gabimeve të tij dhe krijon në mjediset e të nxënësve një klimë të të përfituarit nga gabimet;
9. nuk përfiton financiarisht ose materialisht për shkak të detyrës, për veten, të afërmit ose miqtë e tij;

10. plotëson me përpikmëri dokumentet zyrtare, zbaton me përpikmëri rregulloren e brendshme të institucionit dhe vendimet që merren në institucion;
11. mban një nivel të lartë të disiplinës në mjediset e të nxënit;
12. vlerëson rregullisht veten mbi bazën e standardeve të mësuesit dhe standardeve të mësuesit lëndor;
13. përdor me efektivitet kohën e punës;
14. përdor metoda të ndryshme të negociimit, të zgjidhjes së konflikteve dhe të arritjes së konsensusit në marrëdhëniet me kolegët, me nxënësit dhe të nxënësve mes tyre;
15. shmang çfarëdo lloj konflikti interesi dhe njofton drejtorin e institucionit për raste të tilla;
16. kujdeset për kushtet shëndetësore, të higjienës, të sigurisë nga rreziqet dhe për kushtet ekologjike në mjediset e mësimdhënies.

SHTOJCË

SI MUND TË VETËVLERËSOHET MËSUESI?

Mësuesi është përgjegjës për arritjet e nxënësve të tij. Atij i duhet të shqyrtojë herë pas here se si po e përmbush këtë përgjegjësi. Analiza serioze, e detajuar e periodike e vetes mbi bazën e këtyre standardeve i jep një mundësi të çmuar për të kuptuar në kohë pikat e tij të forta dhe ato të dobëta.

Përshkrimet e mëposhtme vlejné thjesht për të ndihmuar mësuesin të vetëvlerësohet dhe jo për t'u vlerësuar nga drejtori i institucionit ose specialistët e njësive arsimore vendore (DAR dhe ZA)

Vetëvlerësimi bëhet me katër nivele dhe secilit nivel i takon një numër i caktuar pikësh. Këto nivele dhe pikët përkatëse janë:

Niveli	Pikët
Shumë mirë	4
Mirë	3
Mjaftueshëm	2
Dobët	1

Mësuesi mund të vlerësojë veten për një bllok treguesish, si p.sh. për aftësitë e tij të komunikimit, ose vetëm për një standard, ose bën një vlerësim tërësor të tij, d.m.th. për të gjitha standardet një nga një.

SHEMBUJ

Standardi: Njohja dhe zbatimimi i dokumentacionit arsimor/ pika 4 “Mësuesi njej procedurat e organizimit të kurrikulës në institucionin arsimor”

Mësuesi tregon si organizohen ofertat e kurrikulës me zgjedhje për nxënësit dhe si përzgjedhin nxënësit. Mësuesi i gjimnazit sjell shembuj të kurrikulës bërthamë për një klasë dhe të kurrikulës me zgjedhje për një nxënës..

Standardi: Etika dhe sjellja/ pika 8 "Mësuesi është transparent në veprimtarinë e tij dhe krijon në mjediset e të nxënësit kulturën e transparencës"

Në këtë tregues, ashtu si edhe në disa tregues të tjerë, kërkohet që mësuesi, jo vetëm, të gëzojë një virtut profesional, siç është transparenca e veprimeve të tij, por edhe të jetë i aftë të krijojë të njëjtën kulturë me nxënësit e tij.

Pra, vetëvlerësimi ka dy përmasa. Njëra përmasë është thjesht veçori e karakterit të tij (A është transparent ai?), kurse përmasa tjetër është një aftësi profesionale (A është ai i aftë të kultivojë kulturë e transparencë me nxënësit e tij?).

Jo vetëm për këtë tregues, por edhe për shumë të tjerë, mësuesi mund të pandehë se i ka punët mirë, por mund të mos jetë krejtësisht kështu. Pyetësorë anonimë me nxënësit e prindërit për aspekte të caktuara të punës së tij, i japin mundësi të vlefshme atij të plotësojë më saktë pikët e veta.

Standardi: Etika dhe sjellja/ pika 5. Këtu janë tre nëntregues. Nëse mësuesi është i interesuar në mënyrë të veçantë të kuptojë sa i përmbush këta tregues, do të duhet të analizojë veç e veç secilin nëntregues. Pastaj gjen shumën e pikëve. Këtë shumë e pjesëton me numrin e treguesve dhe rezultatin e rumbullakos me një shifër pas presjes.

P.sh.:

	TREGUESI	VLERËSIMI	PIKËT
a)	Përdor stile dhe praktika të ndryshme të komunikimit me nxënësit, kolegët, prindërit etj.	Mirë	3
b)	Komunikon hapur, në mënyrë korrekte, bindëse dhe frymëzuese me nxënësit.	Mirë	3

c)	Krijon në mjediset e të nxënit një frymë të komunikimit të hapur e të lirshëm të nxënësve me të dhe të nxënësve mes tyre.	Mjaftueshëm	2
	SHUMA E PIKËVE		8
	MESATARJA E PIKËVE		8:3=2,7

Kur kjo mesatare është 1 deri në më pak se 1,8, atëherë komunikimi është "Dobët". Mesatarja nga 1,8 deri në më pak se 2,5 tregon që komunikimi është "Mjaftueshëm". Komunikimi është "Mirë", kur mesatarja e pikëve është nga 2,5 deri në më pak se 3,3, kurse mbi 3,3 është "Shumë mirë". Në shembullin e mësipërm, mësuesi e ka "Mirë" bllokun e komunikimit.

Në të njëjtën mënyrë mund të llogaritet mesatarja e pikëve për një standard duke marrë një për një të gjithë nëntreguesit.